Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- | | |
|--|--|
| 23. Njoftimi i Fituesit | 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese. |
| 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës | <p>1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.</p> <p>2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.</p> <p>Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor; b) garanci bankare; c) garanci nga shoqëri sigurimi. |

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike..

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin përfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE³

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

³ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlere absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**
_____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt: “Furnizim vendosje pajisje mjekësore për SUT” e ndare në 7 lote si më poshtë:

• LOTI 1 – “Furnizim/vendosje Pajisje Mjekësore për Autoambulancat e SUT”

Artikulli	Njësia	Sasia
Respirator Transporti	Copë	1
Defibrilator/Monitor	Copë	1
Aspirator për ambulancë	Copë	1
Set emergjence për ambulancë	Set	1

SPECIFIKIME TEKNIKE:

1. Respirator Transporti

Respirator transporti me funksione të avancuara për mbrojtjen e mushkërive për pacientë adult, pediatrikë dhe neonatal.

I lehtë, portabël dhe me turbinë të integruar. Peshë jo më tepër se 7 kg.

Të jetë robust, i qëndrueshëm dhe i përshtatshëm për tu përdorur në kushte të vështira atmosferike.

Të ketë ndërfaqe kontrolli me ekran me prekje (touch screen) me dimension të paktën 10", rezolucion min. 1280x800 piksela.

Të jetë pajisur me sensor oksigjeni jetëgjatë i cili nuk konsumohet dhe nuk ka nevojë për mirëmbajtje.

Furnizimi me gaze mjekësore ajër dhe oksigjen në intervalin e përafërt të presionit në intervalin nga 3 deri në 6 atm.

Të ketë sistem elektronik i përzierjes së gazeve për të garantuar FiO₂ në intervalin të rregullueshëm nga 21 deri në 100%.

Të ketë alarm zanor dhe vizual për volumin tidal, volumin minutë, FiO₂, presionin, APNEA, etj.

Fluksi maksimal jo më pak se 260 L/min.

Të mundësojë regjistrimin e trendeve tabulare dhe grafike deri në jo më pak se 120 orë.

Të ofrojë paraqitje simultane për të paktën 4 (katër) forma valore: Fluks, Presion, kurba CO₂ dhe të paktën një kurbë spirometrie.

Të mundësojë kompensim të humbjeve në qark si dhe kompensim automatik në bazë të lartësisë mbi nivelin e detit.

Të përfshihen modalitetet e Respirimit:

Kontroll Volumi,

Kontroll Presioni,

Respirim i Sinkronizuar me pacientin SIMV me kontroll Volumi dhe kontroll Presioni,

Respirim me dy nivele presioni,

Respirim jo-invaziv (NIV),

Modalitet CPAP,

Modalitet me lëshim presioni APRV,

Modalitet emergjence CPRV me një buton,

Modalitet me mbështetje Volumi.

Të përfshihen funksionet "Rapid Shallow Breathing" RSB, presionin e bllokimit P 0.1.

Të përfshihet funksion i avancuar për testimin e kapacitetit respirator spontan të pacientit me kohë të rregullueshme.

Të përfshihet funksioni neonatal.

Të ketë opsion për monitorim të CO₂ dhe modul monitor pacienti.

Të ketë opsion për monitorim të vazhdueshëm të parametrave jetikë gjatë transportit të cilët mund të eksportohen në një sistem qëndror monitorimi në kohë reale si dhe sinkronizim automatik i parametrave me ventilator stacionar, pa patur nevojën e rregullimeve manuale.

Të përfshihet paketë e avancuar llogaritjesh pulmonare për raportin e saturimit dhe fraksionit të oksigjenit të inspiruar, volumi i hapësirës së vdekur, ventilimi alveolar etj.

Saktësia e kontrollit të përzierjes Ajër/O₂ të ofrohet : $\pm 3\%$ ose më mirë.

Presioni inspirator i rregullueshëm të jetë të paktën në rangun nga 1 deri në 80 cmH₂O.

Volumi tidal të jetë: në rangun 2÷3000 mL ose më mirë.

Raport I/E i ndryshueshëm të jetë nga 1:10 deri në 4:1 ose më mirë.

PEEP i rregullueshëm të jetë: në rangun 0÷50 cmH₂O ose më mirë.

Frekuenca respiratore e rregullueshme në intervalin 2 deri në 150 bpm ose më mirë.

Trigger Fluksi të jetë në rangun nga 0.2 deri në 18 Litra/min ose më mirë.

Trigger Presioni të jetë në rangun nga -18 deri në -0.5 cmH₂O ose më mirë.

Furnizimi me energji AC të jetë 220 deri në 240 V/50Hz. DC: 12-24V

Pajisur me bateri të integruar për të paktën 10 orë autonomi.

Me tregues të gjendjes së baterisë edhe kur respiratori është i fikur.

Të jete i pajisur me portë USB, ethernet, Wi-Fi.

Me mbrojtje kundër ujit dhe pluhurit: IP34 ose më mirë.

Të jetë në përputhje me standardet EN 13718-1, EN 1789, RTCA/DO-160G, EN 794-3 për përdorim në mjete transporti si ambulanca dhe helikopterë.

Të shoqërohet me set respirator me një përdorim adult me sensor fluksi dhe filter, maskë NIV dhe kanjulë nazale për terapi oksigjeni.

Pajisja mjekësore e kërkuar më sipër duhet të plotësojnë detyrimit të këto kushte:

-Garanci: Jo më pak se 1 (Një) Vit duke filluar nga data e vendosjes në funksion të pajisjes.

-Pajisjet mjekësore të jenë sipas standardeve CE ose FDA,

-Afati i furnizimit: Brenda dy muajve ose gjashtëdhjetë ditë duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës së furnizimit.

-Afati i vendosjes: Sipas kërkesave të AK

Sasia: Cope 1

2. Defibrilator/Monitor

Defibrilator Bi-Fazik me Pacer për arrestet kardiake akute dhe kronike

Me karikues dhe bateri.

Pesha e lehtë (jo më shumë se 4.5 kg) dhe modeli i teknologjisë së fundit

Tensioni i hyrjes 220-240 VAC, 50/60 Hz;

Mënyrat e punës: Manuale, Pacer, AED dhe Monitorim

Monitor LCD/TFT me ngjyra me rezolucion min. 1200x1010

Madhësia jo më pak se 9" (touchscreen) me prekje.

Shfaqje e min. 7 formave valore njëkohësisht.

Të ketë kënd shikimi të paktën 160° dhe mundësi ndriçimi automatik.

Zgjedhja manuale maksimale deri në 360 J.

Diapazoni i energjisë: min 1-360 J

Koha e karikimit më e vogël se 3 sekonda për energji 200J

Koha e ndezjes së aparatit jo më shumë se 3 sekonda.

Koha e rikuperimit të EKG pas defibrilimit: jo më shumë se 2.5 sek

Mundësi monitorim të formave valore: EKG 12 lead, , HR, SPO2, CO2, NIBP, IBP, etj.

Duhet të monitorohet EKG përmes paddles, pads dhe elektrodave të monitorimit dhe Defibrilim përmes pads dhe paddles.

Të ketë opsion për analizimin e EKG 12 kanale dhe mundësi krahasimi në ekran të 2 raporteve EKG 12 kanale.

Të ketë të inkuorporuar modalitetin e trajnimit CPR

Duhet të ketë Defibrilim automatik dhe manual

Të ketë të instaluar funksionet për SpO2, temperaturë dhe mundësi shtimi për NIBP, CO2, IBP dhe EKG me 12 kanale.

Duhet të ketë regjistruar automatik dhe manual të integruar për printimin e informacionit të ruajtur të EKG-së.

Pacing: min. 30 - 200ppm

Saktësia: $\pm 2\%$

Rezolucion: 5 ppm

Me tregues dixhital në ekran të gjendjes së baterisë.

Të ketë një bateri që mban jo më pak se 270 goditje 200J, ose 6 orë monitorim.

Koha e karikimit të baterisë: 3-4 orë.

Treguesi i karikimit të jetë në ekran.

Duhet të ketë tregues, që tregojnë statusin e impedancës së kontaktit midis pacientit dhe dorezave, si në ekran ashtu edhe në dorezat e jashtme.

Pajisur me printer termal me 6 kanale.

Të jetë me memorje të brendshme deri në 100 orë forma valore të EKG.

Ndërfaqe: USB dhe LAN, Wi-Fi

Rezistenca ndaj ujit e goditjeve: $\geq$ IP55 dhe rezistente nga rënia në jo më pak se 2m lartësi.

Të jetë në përputhje me standardet EN1789, MIL-STD-810G, RTCA-DO-160G

Të ketë mundësinë të dërgojë të dhëna në kohë reale në Monitor Qëndror.

Të shoqërohet me aksesoret:

Dorezat shumëpërdorimshe Adulte/Pediatrike

Kabëll ekg 10 lead

Sensor oksimetrie

Pajisja mjekësore e kërkuar më sipër duhet të plotësojnë detyrimisht këto kushte:

-Garanci: Jo më pak se 1 (Një) Vit duke filluar nga data e vendosjes ne funksion të pajisjes.

-Pajisjet mjekësore të jenë sipas standardeve CE ose FDA,

-Afati i furnizimit: Brenda dy muajve ose gjashtëdhjetë ditë duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës se furnizimit.

-Afati i vendosjes: Sipas kërkesave te AK

Sasia: Cope 1

3. Aspirator për ambulancë

Aspirator portabël për ambulancë me vakum dhe fluks të lartë.

Pesha jo më tepër se 5 kg.

Cikli i punës: i vazhdueshëm.

Me bateri të rikarikueshme të integruar dhe tregues LED për gjendjen e saj.

Autonomia e baterisë jo më pak se 40 minuta.

Shishe e autoklavueshme me valvul sigurie me kapacitet minimumi 1 litër.

Fluksi: jo më pak se 30 L/min.

Vakum i rregullueshëm deri min. 0.8 bar.

Pajisur me llambë ndriçimi dhe hapësirë për vendosjen e aksesorëve.

Niveli i zhurmës jo më tepër se 65 dBA.

Klasa e mbrojtjes nga likuidet: min. IP34.

Aksesorët e përfshirë: Çantë mbajtëse , karikues baterie, montuese për ambulancë, filtër hidrofobik bakterial (2 copë), set tub silikoni, kanjulë sterile njëpërdorimshe, rregullator manual steril një përdorimësh.

-Garanci: Jo më pak se 1 (Një) Vit duke filluar nga data e vendosjes ne funksion të pajisjes.

-Pajisjet mjekësore të jenë sipas standardeve CE ose FDA,

-Afati i furnizimit: Brenda dy muajve ose gjashtëdhjetë ditë duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës se furnizimit.

-Afati i vendosjes: Sipas kërkesave te AK

Sasia: Cope 1

4. Set emergjence

Set emergjence për ambulancë në të cilin të përfshihen:

Çanta mbajtëse e setit me përmasa afërsisht 54 x 35 x 33 cm

Ambu reanimimi me maskë nr. 4 - adult

Maskë nr. 2 për fëmijë

Mbulesë emergjence

Gërshërë universale - 16.5 cm

Pinca për mbajtjen e gjuhës

Pinca Magill - 20 cm

Hapëse dhëmbësh

Tourniquet

Tub oksigjeni - 120 cm

Tuba Guedel të ndryshëm - kuti me 10 copë

Stetoskop

Aparat tensioni

Termometër

Set laringoskopi 3 tehe Mc-Intosh 2-3-4

Njësi thithëse dore

Ndriçues oral

Oksimetër gishti

Peceta dezinfektuese - 100 peceta

Fashë elastike

Fashë garze 3.5 m x 7 cm - kuti me 10 copë
Fashë ngjitëse sterile 10 x 10 cm - kuti me 5 copë
Akull i gatshëm - qese 3 copë

-Garanci: Jo më pak se 1 (Një) Vit duke filluar nga data e vendosjes ne funksion të pajisjes.

-Pajisjet mjekësore të jenë sipas standardeve CE ose FDA,

-Afati i furnizimit: Brenda dy muajve ose gjashtëdhjetë ditë duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës se furnizimit.

-Afati i vendosjes: Sipas kërkesave te AK

Sasia: Cope 1

• LOTI 2 – “Furnizim/vendosje Aparat EKG për shërbimet mjekësore”

SPECIFIKIME TEKNIKE PËR EKG MULTIFUNKSIONALE ME 12 KANALE:

Elektrokardiogramë me 12 kanale e cila duhet të jetë portative me ushqim AC 100V deri 240 V 50/60HZ, për përdorim spitalor.

Të jetë me bateri të integruara dhe të mbajë bateri minimumi 1(një) orë duke bërë ekzaminime. Mënyra e funksionimit të jetë dhe automatike dhe manuale.

Të arrijë frekuencat 0.05Hz deri në 150 Hz.Të jetë me sensitivitet 2.5, 5, 10, 20, 10/5, AGC(mm/mV). Shpejtësia e regjistrimit të jetë 5, 6.25, 10, 12, 25, 50 mm/s.

Regjistrim afatgjatë prej te pakten 10 minutash me detektim automatic te aritmise

Rezistenca e hyrjes te jete me e mdhe se 50MΩ

CMRR te jete te pekten 100dB

Printimi i letrës të jetë termik. Të ketë mundësi lidhje me PC për të transferuar të dhënat.

Të ketë portë USB për lidhje me printer të jashtëm.

Memoria e brendshme të ketë mundësi zgjerimi me USB ose SD card dhe të arrijë të regjistrojë minimumi 200 ekzaminime.

Gjtashtu OE i cili do realizojë furnizimin me EKG në SUT duhet të sjellë fisha rezervë për cdo EKG që do sjellë. Të mbajë garanci minimumi 1(një) vit nga data e furnizimit. Nevojat për EKG janë shërbimet mjekësore në SUT, gjithsej 5 copë.

-Garanci: Jo më pak se 1 (Një) Vit duke filluar nga data e vendosjes ne funksion të pajisjes.

-Pajisjet mjekësore të jenë sipas standardeve CE ose FDA,

-Afati i furnizimit: Brenda dy muajve ose gjashtëdhjetë ditë duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës se furnizimit.

-Afati i vendosjes: Sipas kërkesave te AK

Sasia: Cope 5

• LOTI 3 – “Furnizim/vendosje Aparat EKO”

Specifikime teknike për pajisjen mjekësore Aparat EKO:

Teknologji bazuar ne perpunimn kompjuterik per formimin e figures se ECHO-s bazuar ne perpunimin e te dhenave te kanaleve digjitale.

Aplikimet qe duhet te ofroje sistemi:

- Abdominale
- Obstetrik
- Gjinekologjik
- Kardiak
- Urologji
- Vaskular

- Pediatri
- Mjekesi emergjence
- Diapazoni dinamik total i sistemit te jete te pakten 300dB.

Minimumi i modalitetit te skanimit: B, M, THI, PD, PWD, COLOR DOPPLER, CW, Anatomik M,

Sistemi duhet te ofroje te pakten 3.000.000 kanale procesimi

Sistemi duhet te kete nje kufi dinamik (dynamic range) mbi 10-90dB per te arritur te kape dhe analizoje reflektimet e dobeta.

Thellesia e skanimit min. 1cm deri 35cm ne varesi te sondes.

Monitori per interpretim te ECHO-s duhet te jete me ngjyra dhe min. 21”(inch). Duhet te plotesoje konditat e rezolucionit te larte, qe duhet te jete mbi ose 1920x1080 pixel, standarti HD.

Sistemi duhet te ofroje mundesine e punes ne triplex (simultane).

Te jete e mundur qe te vendosen te dhenat (Presets) te pershtatshme sipas nevojave te doktorit.

Te kete nje ndezje sa me te shpejte por jo me shume se 120 sek.

Metodat e post perpunimit per zvogelimin e njollave ne 3 nivele, gray maps min 7 nivele dhe color maps min 16 nivele

Trackball me sensitivitet te larte.

Paneli i kontrollit duhet te jete min.13” dhe komandim me prekje (touch screen) dhe te kete te pakten 2 porta USB.

Te jete i pajisur me tastier numerike ne ekranin me prekje (touch screen) sikurse edhe ne kosolen e pajisjes .

Paisja duhet te kete nje bateri te perfshire per te mundesuar punen ne mungese te ernergjise elektrike. Echo duhet te punoje min. 1h ne menyre te vazhduar skanimit ne menyre autonome pa energjie elektrike.

Doppler spectral: Frekuenca e perseritjes min.15 kHz ne PW (pulse doppler) dhe ne regjimin e CW (continues wave) jo me e vogel se 50kHz.

Paisja duhet te mundesojte fluks me rezolucion te larte hapsinor per profilizim te sakte te eneve te gjakut.

Sistemi duhet te kete minimumi 4 Porta per te vendosur sonda te ndryshme te cilat zgjidhen ne menyre elektronike nga operatori.

Sistemi duhet te jete i pajisur edhe me ngrohesisin e xhelit.

Frekuenca e punimit te sondave duhet te suportojte nga min.1,5 -12 MHz.

Sonda kardiake me frkuence pune mbi 1.4 MHz deri ne 4.4 MHz. Fusha e skanimit mbi 85°. Aplikimet qe duhet te perdoret: Kardiake, Abdomen, Mushkri, Renal.

Sonda konvekse me frekuenca pune mbi 1,7 MHz deri ne 4.9 MHz. Fusha e skanimit mbi 65 °. Aplikimet qe duhet te perdoret: Abdomen, Renal, eko fetale, Obstetrike, vaskular, urologji, gjinekologji

Sonda Lineare ne frekunce pune mbi 4 MHz deri ne 12 MHz. Fusha e pamjes min. 120 mm. Aplikimet qe duhet te perdoret : Gjiri, Vaskulare, Tiroide, Muskulare, ortopeedike, venoze

Sistemi duhet te kete menaxhimin e informacionit te pacienteve , ruajtja e ketij informacioni, transferimi ne media te ruajtjes se ketij informacioni per te patur nje histori te ekzaminive te pacienteve.

Sistemi duhet te kete protokoll per komunikimin me pajisje te tjera ne dalje te tij nepermjet WiFi.

Sistemi duhet te jete pajisur me printer B/W (bardh e zi).

Pajisja duhet te disponoje hard disk per hapësirë ruajtëse min.500 GB, me RAM te pakten 16 GB DDR4 dhe min. memorje 200,000 imazhe.

Pajisja duhet te suportojte formate per imazhe te tipit JPG, TIFF, ndersa per cine formate te tipit AVI per te mundesuar egzaminime offline.

Software duhet te suportojte backup te te dhenave te pacienteve dhe egzaminimeve ne USB dhe CD/DVD

-Garanci: Jo më pak se 3 (Tre) Vjet duke filluar nga data e vendosjes ne funksion të pajisjes.

-Pajisjet mjekësore të jenë sipas standardeve CE ose FDA,

-Afati i furnizimit: Brenda dy muajve ose gjashtëdhjetë ditë duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës se furnizimit.

-Afati i vendosjes: Sipas kërkesave te AK

Sasia: Cope 1

• **LOTI 4 – “Furnizim/vendosje pajisje Video choledochoscopy intraoperative dhe aksesoreve kompatibel me kolonën e endoskopise (STORZ)”**

SPECIFIKIME TEKNIKE PËR VIDEO CHOLEDOCHOSCOPY INTRAOPERATIVE DHE AKSESOREVE KOMPATIBEL ME KOLONEN E ENDOSKOPISE (STORZ) QE ËSHTË NE PËRDORIM NE BLOKUN OPERATOR:

VIDEO-KOLEDOCHOSCOPY INTRAOPERATIV

- Video-endoskop fleksibel HD për vizualizim dhe ndërhyrje ne traktin biliar, kompatibel me kolonën ekzistuese te endoskopise KARL STORZ
- Me pamje ballore, me gjatësi mbi 35cm dhe diametër me te vogël se 5.5mm.
- Pajisur me kanal pune mbi 2.2mm dhe ndriçim te integruar.
- Kthyeshmeria e majës lart/poshtë te paktën 200°/140°.
- Me butona te programueshem dhe kanal aspirimi.
- Furnizuar me testues rrjedhjesh dhe çantë transporti.

-Garanci: Jo më pak se 1 (një) Vit duke filluar nga data e vendosjes ne funksion të pajisjes.

-Pajisjet mjekësore të jenë sipas standardeve CE ose FDA,

-Afati i furnizimit: Brenda dy muajve ose gjashtëdhjetë ditë duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës se furnizimit.

-Afati i vendosjes: Sipas kërkesave te AK

Sasia: Cope 1

• **LOTI 5 – “Furnizim/vendosje pajisje mjekësore per Kliniken e Sëmundjeve te Brëndshme”**

SPECIFIKIME TEKNIKE:

1. Lavatrice per larje dhe dezinfektim automatik te endoskopeve

- Sistem portativ me rrota, për te paktën një video-endoskop fleksibel
- Me ekran te madh te paktën 12" për vendosjen dhe monitorimin e parametrave te punës.
- Pajisur me një nderfaqje e thjeshte përdorimi dhe monitorimi.
- Me sistem identifikimi te endoskopeve për shmangjen e gabimeve si dhe gjurmim te gjithë ciklit te pastrimit dhe me mundësi dokumentimi dhe raportimi ne printerin e integruar
- Me hyrje për furnizimin e ujit dhe ajrit te komprimuar
- Me dalje te dedikuar për evakuimin e avujve dhe aromave te padëshiruara
- Me te paktën 4 konteinere për detergjente, dezinfektante dhe alkool
- E afte për plotësimin e ciklit brenda 20 minutash.
- Me sistem monitorimi te kanaleve te pastrimit
- Me mbajtës (basen) te madh për akomodimin e gjithë llojeve te endoskopeve
- Pajisur me te paktën 8 pozicione lidhjeje për kanale uji, ajri, shpëlarje jet, testimi rrjedhjesh, biopsie etj.

- Pajisur me pedal për hapjen e kapakut për parandalimin e kontaminimeve
- Pajisja të plotësojë standardet evropiane të riprosimit UNI EN ISO 15883
- Dimensionet e përafërta 70x70x100cm
- Konsumi jo më i madh se 300W
- Furnizimi 230 V; 50/60 Hz
- Te furnizohet me një set lidhjeje për video-endoskopet ekzistues (Gastrospoce Storz Standard 13821 PKS dhe Colonoscope Storz Standard 13924 PKS)
- Te furnizohet me një set fillestar detergjentesh dhe dezinfektantesh.

Pajisja mjekësore e kërkuar më sipër duhet të plotësojnë detyrimisht këto kushte:

-Garanci: Jo më pak se 1 (Një) Vit duke filluar nga data e vendosjes në funksion të pajisjes.

-Pajisjet mjekësore të jenë sipas standardeve CE ose FDA,

-Afati i furnizimit: Brenda dy muajve ose gjashtëdhjetë ditë duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës së furnizimit.

-Afati i vendosjes: Sipas kërkesave të AK

Sasia: Cope 1

2. Aparat elektrokoagulum

- Gjenerator me frekuencë të lartë me një gamë të gjerë funksionesh monopolare dhe bipolare në gastroenterologji.
- Fuqia maksimale të paktën 200W.
- Me dalje monopolare dhe bipolare.
- Me ekran tregues për shfaqjen e parametrave të punës.
- Me monitorim të elektrodës neutrale.
- Furnizuar me doreze monopolare, elektroda të trashë dhe sfera, elektrode neutrale, dhe pedal dysh për komandim.
- Aparati duhet të furnizohet bashkë me 30 laqe kompatibel me pajisjen (Standart polypectomy snares)

Pajisja mjekësore e kërkuar më sipër duhet të plotësojnë detyrimisht këto kushte:

-Garanci: Jo më pak se 1 (Një) Vit duke filluar nga data e vendosjes në funksion të pajisjes.

-Pajisjet mjekësore të jenë sipas standardeve CE ose FDA,

-Afati i furnizimit: Brenda dy muajve ose gjashtëdhjetë ditë duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës së furnizimit.

-Afati i vendosjes: Sipas kërkesave të AK

Sasia: Cope 1

• LOTI 6 – “Furnizim/vendosje pajisje Fibrobronkoskop”

SPECIFIKIME TEKNIKE PËR PAJISJE FIBROBRONKOSKOP:

- I përshtatshëm për diagnostikim, ndërhyrje apo intubim
- Të jetë i përshtatshëm për tu përdorur me pajisjet endoskopike ekzistuese (Storz)
- Pajisje ballore me kënd të gjërë 110°

- Diametri i tubit të jashtëm me I vogël se 5.5 mm dhe gjatësia e punës 50-55 cm, kthimi i majës 180°/100°
- Me kanal pune për aksesore me diametër mbi 2.2 mm
- I sterilizueshem
- Pajisur me cante transporti dhe aksesore

-Garanci: Jo më pak se 1 (një) Vit duke filluar nga data e vendosjes në funksion të pajisjes.

-Pajisjet mjekësore të jenë sipas standardeve CE ose FDA,

-Afati i furnizimit: Brenda dy muajve ose gjashtëdhjetë ditë duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës së furnizimit.

-Afati i vendosjes: Sipas kërkesave të AK

Sasia: Cope 1

• LOTI 7 – “Furnizim/vendosje për Pajisje Mjekësore Ablacion Ultrasonik”

Pajisje Ablacioni Ultrasonik

Pajisje Ablacioni Ultrasonik i përdorshëm në fusha të ndryshme kirurgjikale, si kirurgjia gastrointestinale, urologjike, e përgjithshme dhe laparoskopike. Për heqjen e tumoreve (beninje dhe malinje), indeve të padëshiruara dhe parenkimës së organeve si mëlçia dhe veshkat, në procedura të hapura apo minimalisht invazive, përfshirë reseksione, hepatektomi, nefrektomi dhe ndërhyrje të tjera të avancuara kirurgjikale.

Funksionalitetet kryesore:

- Fragmentim, irrigim dhe aspirim i integruar.
- Ruajtje e integritetit të enëve të gjakut.
- Ekran me ngjyra dhe me prekje (touchscreen) me madhësi minimumi 10".
- Funksion testimi për handpiece me rritje automatike të fuqisë deri në 100%.
- Detektim automatik i:
 - Lidhjes së pedalit,
 - Lidhjes së handpiece-it,
 - Vendosjes së kartrixhës
- Funksion për mbushjen fillestare të tubave të irrigimit.
- Indikator për alarmet.
- Menu ndihmëse me informacion bazik për:
 - Funksionimin,
 - Diagnostikimin.
 - Montimin/çmontimin e aksesorëve,
 - Pastrimin.

Parametrat teknikë:

- Të paktën 5 nivele sensitiviteti.
- Amplituda e majës e rregullueshme të paktën 10% në 100%
- Amplitudë Konstante me fuqi shtesë, edhe nën ngarkesë.
- Amplituda e majës: 420um #5 um.
- Irrigimi: i rregullueshëm të pakten në diapazonin 3-20 ml/min

- Presioni aspirimit: në diapazonin 630-640 mmHg.
- Fluksi i aspirimit: i rregullueshëm të paktën në diapazonin 10-100%
- Minimumi 2 modalitete aspirimi:
 - Aspirim konstant,
 - Aspirim gjatë aktivizimit të fragmentimit.
- Të paktën 2 frekuenca pune: 23-24 kHz dhe 35-36kHz.
- Doreza të dedikuara për secilën frekuencë
- Modalitet pritje për pajisjen.
- Modul lidhjeje për elektrobisturi ne dorezë.

Karakteristikat e pedalit të komandimit:

- Të ketë të paktën 2 funksione:
 1. Aktivizimi i irrigit,
 2. Aktivizimi i amplitudës.
- Dy menyra funksionimi për amplitudën:
 - Ndezur/ fikur - të aktivizohet menjëherë në nivelin e vendosur.
 - Proporcionale-amplituda të rritet në varësi të shtypjes së pedalit.

Karakteristikat e dorezës:

- Teknologji me element piezoelektrik
- Doreza 23-24 kHz të ketë peshë jo më shumë se 105 gramë
- Gjatësia e kabllit: të paktën 4 m
- Minimumi 4 lloje majash për handpiece 23-24 kHz.

Aksesorë të përfshirë:

1. Trolley me 4 rrota.
2. Doreza 23-24 kHz
3. Pedal komandues.
4. Set tubash dhe kartrixh i përshtatshëm për dorezë 23-24 kHz.
5. Maja standarde për dorezën 23-24 kHz- 1 copë.
6. Maja e madhe për dorezën 23-24 kHz- 1 copë
7. Mbajtëse për montimin e majës në dorezë.
8. Çelës për montimin e majës.
9. Kuti sterilizimi për dorezën.

-Garanci: Jo më pak se 1 (një) Vit duke filluar nga data e vendosjes ne funksion të pajisjes.

-Pajisjet mjekësore të jenë sipas standardeve CE ose FDA,

-Afati i furnizimit: Brenda dy muajve ose gjashtëdhjetë ditë duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës se furnizimit.

-Afati i vendosjes: Sipas kërkesave te AK

Sasia: Cope 1

Shtojca 7.*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)**(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)***FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*****“Furnizim vendosje pajisje mjekësore për SUT” e ndare në lote*****Sasia e mallit që kërkohet:**

Nr.	Loti 1 “Furnizim/vendosje Pajisje Mjekësore për Autoambulancat e SUT”	Njesia	Sasia
1	F.V Respirator Transporti	copë	1
2	F.V Defibrilator/Monitor	copë	1
3	F.V Aspirator për ambulancë	copë	1
4	F.V Set emergjence për ambulancë	copë	1
Nr.	Loti 2 "Furnizim/vendosje Aparat EKG për shërbimet mjekësore"	Njesia	Sasia
1	F.V Ekg Multifunksionale Me 12 Kanale për shërbimet mjekësore	copë	5
Nr.	Loti 3 "Furnizim/vendosje Aparat EKO	Njesia	Sasia
1	F.V Aparat EKO per Shërbimin e Imazherisë	copë	1
Nr.	Loti 4 "Furnizim/vendosje pajisje Video choledochoscopy intraoperative dhe aksesoreve kompatibel me kolonën e endoskopise (STORZ)”	Njesia	Sasia
1	F.V Pajisje Video choledochoscopy intraoperative kompatibel me kolonën e endoskopise (STORZ) per Bllokun Operator	copë	1
Nr.	Loti 5 "Furnizim/vendosje pajisje mjekësore per Klinikën e Sëmundjeve të Brëndshme"	Njesia	Sasia
1	F.V Lavatrice per larjen dhe sterilizimin e skopeve	copë	1
2	F.V Aparat elektrokoagulim	copë	1
Nr.	Loti 6 "Furnizim/vendosje pajisje Fibrobronkoskop "	Njesia	Sasia
1	F.V Pajisje mjekësore Fibrobronkoskop për Shërbimin e Anestezi-Reanimacionit	copë	1
Nr.	Loti 7 "Furnizim/vendosje për Pajisje Mjekësore Ablacion Ultrasonik "	Njesia	Sasia
1	F.V Pajisje Mjekësore Ablacion Ultrasonik per Shërbimin e Klinikës së Kirurgjisë së përgjithshme	copë	1

Afatet e lëvrimit: Te gjithë mallrat/paisjet e loteve duhet te furnizohen brenda dy muajsh (ose 60 dite) duke filluar nga data e nënshkrimit te kontratës se furnizimit sipas Marrveshjes kuadër per periudhën 12 mujore.

Sqarim: Ak do te nënshkruaj ne fillim Marrveshjen kuadër me OE te shpallur fitues dhe me pas do te nënshkruhen kontratat sipas nevojave dhe fondeve ne dispozicion te Ak per vitin 2025 dhe vitin 2026. Kontratat do te nënshkruhen brenda periudhës 12 mujore dhe afati i furnizimit (periudha dy mujore) do te filloje menjëherë me nënshkrimin e kontratave te furnizimit.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohe për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohe për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta të kualifikimit do të jenë të njëjtat për të gjitha lotet

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për tre vitet e fundit (2022-2023-2024). Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë duhet të jetë në masën 39% të fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave, të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron.

Shënim:* Kur konkurrohet për më shumë se 1 lot, vlera 39% do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

*Shënim**Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

2.3.1 Minimumi 19% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse ofertohet për më shumë se një lot).

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
